



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3, Tiranë; Tel-Fax: 0693067738

E-mail: rmuca@klsb.org.al; Web-site: www.klsb.org.al

Auditim performance: "PERFORMANCA E IQT NË GARANTIMIN E CILËSISË SË TREGTIMIT TË NAFTËS DHE NËNPRODUKTEVE TË SAJ NË SHQIPËRI"

Përmbledhje Ekzekutive

Në zbatim të planit vjetor 2015, Kontrolli i Lartë i Shtetit, në kuadër të përmbushjes së funksionit të tij Kushtetues, zbatimit të Udhëzimeve dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI, EUROSAI etj.), sipas shkresës nr. 611/1, datë 16.11.2015, Program Auditimi, ndërmori auditimin me temë "Performanca e IQT në garantimin e cilësisë së tregtimit të naftës dhe nënprodukteve të saj në Shqipëri".

Ky auditim u programua për t'u ushtruar në Inspektoratin Qendror Teknik (IQT), aktualisht Inspektorati Shtetëror Teknik Industrial (ISHTI) për periudhën e aktivitetit 2011 – 30 qershor 2015. IQT është institucion publik buxhetor në varësi të ministrit përgjegjës për ekonominë, që drejtohet nga Kryeinspektori, i cili emërohet dhe shkarkohet nga Ministri përgjegjës për ekonominë. IQT, sipas organikës duhet të ketë 100 punonjës gjithsej, të shpërndarë në pesë drejtori, si Drejtoria e Inspektimit të Naftës dhe Gazit, Drejtoria e Labororit Qendror të Kontrollit të Naftës dhe Gazit, Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme etj. ISHTI me anë të mbikëqyrjes së tregut, ka për objektiv, midis të tjerave, të sigurojë se produktet e hedhura në treg janë të sigurta, duke mbrojtur konsumatorin dhe duke siguruar se bizneset e ligjshme kanë mundësi që të konkurrojnë në një treg të rregullt dhe të barabartë etj.

Burimi energjetik që dominon dhe vazhdon të mbajë peshën kryesore në Bilancin Kombëtar Energjetik është nafta me nënproduktet e saj në masën 53.17 % të totalit gjithsej në vitin 2012. Bazuar në konsumin e naftës dhe nënprodukteve përkatëse, konsumatori kryesor vazhdon të jetë Sektori i Transportit me 44 % të totalit të konsumit final të burimeve të energjisë, brenda të cilit transporti rrugor e dominon pothuajse plotësisht me 86 % ndaj totalit të sektorit, ndjekur nga Sektorët e Banesave dhe Industrisë. Përdorimi masiv i automjeteve private pothuajse nga të gjithë shqiptarët që i disponojnë, bëhet dhe për shkak të mungesës së një transporti urban dhe interurban cilësor.

Sipas të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, sasia e karburanteve të importuara në vitet 2011-2014 ka qenë mesatarisht 859,765 ton në vit, si dhe në vitin 2014 janë përpunuar brenda vendit nga dy rafineritë 300,000 ton naftë. Duke shmangur analizën e koniukturave të tregut ndërkombëtar të naftës në vite, lidhur me sasinë e importuar, shifrat e mësipërme tregojnë se konsumi i karburanteve në Shqipëri është në rritje, së bashku me rritjen e sasisë së karburanteve të prodhuara dhe të përpunuara brenda vendit. Trendi i rritjes së konsumit të karburanteve në vite është i lidhur kryesisht me numrin e mjeteve rrugore, inventari të cilave në vitin 2013 ka arritur në 445,956 copë. Gjithashtu, rritja e përdorimit në shkallë gjithnjë e më të gjerë të naftës së prodhuar në vend vitet e fundit, i kërcënon akoma më shumë treguesit

standardë të cilësisë, jo vetëm për shkak të kostos së ulët në krahasim me atë të importit, por kryesisht si rezultat i teknologjisë shumë të vjetër të rafinerive të përpunimit.

Në këtë kuadër, shteti përcakton politikën e zhvillimit të veprimtarive në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, si dhe ushtron funksionin e tij rregullator, në përputhje me nevojat e vendit, të mbrojtjes kombëtare dhe të sigurimit publik, duke respektuar parimet e ekonomisë së tregut.

Përdorimi i naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre në transport për automjete dhe lëndëve të djegshme për përdorim termik dhe industrial vazhdojnë të gjejnë zgjerim në jetën e përditshme të qytetarëve shqiptarë. Për pasojë, sasia dhe cilësia së tyre ndikojnë nivelin e mirëqenies së popullatës nga ana materiale nëpërmjet çmimit, konsumit për njësi (km, orë, m³ etj.) dhe periodicitetit të kryerjes së shërbimeve teknike (tek automjetet, pajisjet ngrohëse dhe industriale etj.), si dhe nga ana shëndetësore në sëmundshmërinë nga shkarkimet ndotëse në ajër.

Në mënyrë indirekte jetesa e qytetarëve ndikohet nga përdorimi i naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, nëpërmjet performancës së veprimtarisë të agjencive qeveritare të ngarkuara për kontrollin e këtij shërbimi të furnizimit, në drejtim të zbatimit të masave penalizuese për parandalimin e abuzimeve për cilësinë, si dhe zbatimit të detyrimit ligjor për kryerjen e analizave të detyrueshme periodike që paguhen nga vetë subjektet tregtare. Pra, këto agjenci ndikojnë në grumbullimin e të ardhurave buxhetore dhe për pasojë aftësinë investuese nëpërmjet shpenzimeve qeveritare.

Gjithashtu, auditimi publik i jashtëm nëpërmjet KLSH, dhe për më tepër ai i performancës, është funksioni që lidh hallkat e ndryshme të aktiviteteve publike në institucione apo agjenci qeveritare, duke i orientuar ato drejt efektivitetit, eficiencës e ekonomicitetit dhe, në kuadër të këtij auditimi, nxitjen e përdorimit të burimeve alternative të energjisë, në funksion të sigurimit të furnizimit të qëndrueshëm me energji elektrike të vendit.

Në përfundim të punës audituese në terren, me shkresën nr. 611/2 datë 26.11.2015, iu dërgua projekt-raporti i auditimit subjektit të audituar.

Pas respektimit të afatit 1-mujor për observacione nga palët e interesit, subjekti i audituar (ISHTI) me shkresën nr. 9184/4 prot., datë 18.12.2015, ka konfirmuar se pranon dhe është dakord me të gjitha gjetjet dhe konkluzionet e grupit të auditimit të KLSH-së, rekomandimet e të cilit janë prioritet për zbatim nga ISHTI në vijimësi. Më pas, është hartuar në afatin ligjor Raporti përfundimtar i auditimit. Mbi bazën e Vendimit të Kryetarit të KLSH-së nr. 164 dhe nr. 611/5 prot., datë 24.12.2015, janë dërguar rekomandimet përkatëse dhe raporti përfundimtar Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin; MEI-t dhe ISHTI-t me shkresat përkatëse nr. 611/7 prot., nr. 611/8 dhe nr. 611/6 prot., datë 24.12.2015.

Në përfundim, pasi Kryetari u njoh me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projekt-vendimin e paraqitur nga grupi i auditimit të Departamentit të Auditimit të Performancës, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Zbatimit të Standardeve, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeaudituesi dhe Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të nenit 15, shkronja "c" të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit":

K O N K L U D O I:

Ekonomia e vendit dhe e gjithë shoqëria shqiptare kanë nevojë për përdorimin me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet i fondeve dhe pronës publike apo shtetërore. Jo vetëm si konsumatorë, por edhe si taksapagues, qytetarët shqiptar janë të interesuar të marrin shërbimet e duhura në kohë, në cilësi dhe me kosto optimale nga institucionet administratës publike, pasi në tërësi nga mënyra se si funksionojnë dhe menaxhohen varet në një shkallë të ndjeshme niveli i mirëqenies tyre.

Konsumatorët shqiptarë janë të mbrojtur me ligj, jo vetëm për të marrë shërbime me cilësi, por në të njëjtën kohë, midis të tjerave kanë të drejtën mbrojtjes së shëndetit, mjedisit dhe sigurisë së jetës, si dhe të drejtën e mbrojtjes së interesave ekonomikë etj. Në këtë kuadër përfshihet dhe cilësia e naftës dhe nënproduktet e saj, që ofrohen nga tregtarët me pakicë dhe njësitë e lëndëve djegëse, garantimi i së cilës duhet të bëhet nëpërmjet strukturës së posaçme që është ISHTI (ish IQT), me kompetencë vetëm për sa i përket shërbimeve që ju ofrohen konsumatorëve.

Krahas objektivit të përgjithshëm të auditimit të performancës për të evidentuar dhe ndërgjegjësuar nëpërmjet rekomandimeve nëse po bëhen gjërat e duhura në mënyrën dhe kohën e duhur, objektivi specifik është që të auditojmë performancën e IQT si institucion shtetëror, me fokus minimizimin e kostos së kësaj veprimtari publike, pa cënuar cilësinë e saj (pra ekonomikitetin); optimizimin e raportit burime - rezultate të institucionit, duke modifikuar proceset, strukturat dhe gjithë zinxhirin ekonomik të vlerës, në përputhje me standardet përkatëse (pra eficiencën); si dhe arritjen e objektivave të vendosura në përputhje me politikat e subjektit nën auditim (pra efektivitetin).

Gjatë kryerjes së këtij auditimi, jemi përpjekur t'i japim përgjigje pyetjes: A po garanton IQT mbrojtjen e konsumatorit në drejtim të furnizimit me naftë, gaz dhe nënprodukte të tyre?, dhe në përfundim ka arritur në këtë Mesazh auditimi:

Mbrojtja e konsumatorit shqiptar në drejtim të furnizimit me naftë, gaz dhe nënprodukte të tyre me cilësi brenda standardeve nga ana e ISHTI është e mangët, për shkak të kuadrit rregullator të pa bashkërenduar dhe harmonizuar mirë për funksionimin e këtij institucioni; të burimeve njerëzore të pa trajnuara, të pa testuara, të pakualifikuara dhe të keqmenaxhuara; zbatimit me mangësi të procedurave të inspektimit; mungesës së materialeve e modernizimit të pajisjeve laboratorike dhe kryerjes së një numri të kufizuar të treguesve të analizave; problemeve në investime dhe menaxhimin financiar, si dhe për shkak të reduktimit të subjekteve të ndëshkuara dhe mos vjeljes së gjobave.

Nisur nga konkluzionet mësipërme dhe rezultatet e punës audituese, duke synuar përmirësimin e mëtejshëm të këtij sektori Kryetari i KLSH-së:

V E N D O S I:

I. Të miratojë Raportin Përfundimtar të Auditimit të Performancës “Performanca e IQT në garantimin e cilësisë së tregtimit të naftës dhe nënprodukteve të saj në Shqipëri”, të ushtruar në Inspektoratin Qendror Teknik (IQT), aktualisht Inspektorati Shtetëror Teknik Industrial (ISHTI).

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave për sa vijon:

➤ *Në lidhje me çështjen në se është efektiv organizimi, rekrutimi, trajnimi dhe mbikëqyrja e burimeve njerëzore:*

1. ISHTI të marrë masat e nevojshme që nëpërmjet MEI-t të miratojë kuadrin rregullator të organizimit dhe funksionimit, të harmonizuar dhe bashkërenduar mirë midis ligjeve, VKM-ve, Rregulloreve, Udhëzimeve dhe Urdhrave sipas përcaktimeve përkatëse, duke përfunduar bazën ligjore për këtë institucion.

Brenda tremujorit të parë 2016

2. ISHTI të marrë masat e nevojshme për të zbatuar brenda afateve kërkesat ligjore për marrëdhëniet e punës së inspektorëve në bazë të dispozitave të parashikuara në legjislacionin për nëpunësit civilë për institucionet e pavarura.

Menjëherë

3. ISHTI të kërkojë nëpërmjet MEI-t përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të emërimit dhe largimit të kryeinspektorit, duke siguruar qëndrueshmëri të personelit të Inspektoratit dhe për pasojë përmirësim të performancës së institucionit në tërësi.

Menjëherë

4. ISHTI të hartojë një strategji afat shkurtër për të përputhur plotësisht profilin e shkollimit dhe eksperiencës së personelit me atë të fushës inxhinierike të kërkuar, për të rritur performancën e veprimtarisë së inspektorëve dhe për pasojë atë të Inspektoratit në tërësi.

Brenda tremujorit të parë 2016

5. ISHTI të ndërpresë menjëherë veprimtarinë e grupeve të tilla teknike, duke i angazhuar drejtpërdrejtë në inspektim, për të rritur nivelin dhe cilësinë e rezultateve të kontrollit të standardeve të cilësisë së furnizimit me karburante dhe nënprodukte të naftës.

Menjëherë

6. ISHTI të kryejë trajnime dhe testime të herëpashershme sipas kërkesave ligjore, me qëllim që të rritet përgjegjshmëria e Inspektorëve dhe rezultatet e punës së tyre në sigurimin e standardeve të cilësisë së naftës dhe nënprodukteve të saj.

Brenda tremujorit të parë 2016

7. ISHTI të shmangë plotësisht largimet nga puna për shkaqe të paligjshme për pasojë rritjen e kostos së burimeve njerëzore, të plotësojë numrin e punonjësve sipas strukturës organike, duke përdorur kriteret rekrutimi dhe përzgjedhjeje në përputhje me ligjin, si dhe të përgatisë dhe plotësojë dosjet përkatëse, për të rritur performancën e personelit të tij.

Vazhdimisht

8. ISHTI të sigurojë një shpërndarje të drejtë dhe proporcionale midis inspektorëve dhe sektorëve të DING, për të rritur performancën e veprimtarisë kryesore të tyre dhe për pasojë sigurimin e standardeve të cilësisë së tregut të karburanteve.

Brenda muajit Janar 2016

➤ Lidhur me çështjen në se, është zhvilluar në përputhje me legjislacionin procesi i inspektimit për kontrollin e cilësisë dhe dokumentacionit teknik:

9. ISHTI të zbatojë plotësisht procedurën e inspektimit sipas kërkesave ligjore përkatëse, duke u bazuar në metodologjinë e vlerësimit të rrishtit, hartimin e dokumenteve standarde, dhënien e kompetencave të plota inspektorëve për vendosjen e gjobave sipas përcaktimeve të ligjit të posaçëm, si dhe të shmangë aktivizimin në terren të inspektorëve të pakualifikuar dhe të pa testuar.

Menjëherë

10. ISHTI të marrë masa për të përpunuar, administruar dhe ruajtur të gjithë dokumentacionin e veprimtarisë së saj, në përputhje me kërkesat ligjore për arkivën.

Brenda tremujorit të parë 2016

11. ISHTI të miratojë metodikën mbi të cilat duhet të mbështetet inspektori për përcaktimin e vlerës së gjobës, të monitorojë nga afër veprimtarinë e inspektorëve për të shmangë subjektivizmin e tyre në zbatimin e dënimit me gjobë, duke evidentuar përgjegjësitë dhe forcimin e zbatimit të penalizimeve, në funksion të garantimit të cilësisë së karburanteve.

Brenda tremujorit të parë 2016

12. ISHTI të zhvillojë inspektime sa më operative, me sferë të gjerë kontrolli, duke zbatuar me përpikmëri të gjitha kërkesat për dokumentacion në rastin e mostër-marrjes, të përcaktuara në Urdhrin e Ministrit të MEI-t për këtë qëllim, si dhe të hartojë programin vjetor të inspektimeve sipas muajve, duke forcuar rolin e saj dhe rritur performancën në garantimin e naftës dhe nënprodukteve të saj me cilësi brenda standardit.

Vazhdimisht

13. ISHTI të përcaktojë dhe të miratojë procedura të qarta të qarkullimit, kontrollit, ruajtjes dhe krijimit të një baze të dhënash, së bashku me përgjegjësitë përkatëse të inspektorëve në çdo fazë, si dhe të shmangë postet e punës joefektive në veprimtarinë inspektuese.

Brenda muajit Janar 2016

14. ISHTI të përgatisë dhe të paraqesë në MEI një strategji afat mesme për uljen e numrit të stacioneve të furnizimit me karburante dhe shpërndarjen e tyre në varësi të infrastrukturës rrugore, me qëllim që rrisë aftësinë mbuluese me inspektim si dhe shpeshësinë e kontrolleve për garantimin e cilësisë së karburanteve, por gjithmonë pa çënuar furnizimin normal të konsumatorëve dhe pjesëmarrjen konkurruese të operatorëve aktual të këtij tregu.

Brenda tremujorit të parë 2016

15. ISHTI të intensifikojë veprimtarinë inspektuese dhe kontrolluese në rafinerinë dhe në të gjitha impiantet e përpunimit të naftës që e hedhin në treg për konsum me automjete, duke marrë masa ekstreme ligjore deri në propozim për heqjen e licencës subjekteve përsëritjeve në vite apo dhe rasteve të stacioneve në pronësi brenda së njëjtës shoqëri aksionare.

Menjëherë

16. ISHTI, të bashkëpunojë me MEI-n për të përgatitur një ligj të ri “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre” i ndryshuar disa herë, duke përcaktuar heqjen e karburantit jashtë standardit nga shitja.

Brenda gjashtëmujorit të parë 2016

17. ISHTI, të bashkërendojë veprimtarinë me institucionet e tjera si Dogana, Tatime, Drejtorinë e markave, Autoritetin e mbikëqyrjes së sigurimeve, njësitë vendore, Inspektorati shtetëror etj., duke këmbyer të dhëna periodike që i përkasin fushës së karburanteve, për të fuqizuar rolin kontrollues në zbatimin e standardeve të cilësisë për naftën, gazin dhe nënproduktet e tyre.

Menjëherë dhe në vijim periodikisht

➤ *Lidhur me çështjen se, cili ka qenë impakti i aktivitetit të laboratorit në sigurinë e mbrojtjes së konsumatorit:*

18. Nga ana e laboratorit të ISHTI të plotësohet dhe të dërgohet në DPA, dokumentacioni shoqërues si dhe formularët përkatës të publikuar nga DPA për zgjidhjen e MK, para vizitës vlerësuese të radhës, si dhe të merren masa për ruajtjen, arkivimin dhe dokumentimin e veprimtarisë për zgjidhjen e MK, sipas formularëve përkatës dhe të gjithë dokumentacionit në tërësi për laboratorin.

Brenda muajit Janar 2016

19. Laboratori dhe ISHTI të marrë masa:

- për sigurimin e materialeve të nevojshme sipas specifikimeve dhe kriterëve të përcaktuara në procedura dhe standarde për funksionim e aparaturave të laboratorit; për sigurimin dhe furnizimin me pajisjeve për ruajtjen dhe magazinimin e të dhënave për raportet e testeve/analizave;
- për sigurimin e fondeve për blerjen reagentëve dhe CRM-ve për kryerjen e testeve për të gjithë treguesit e paraqitur në fletë analizat e gazoilit, benzinës dhe produkteve të tjera.
- për akreditimin e aparaturave dhe tregueseve të tjerë të analizuar cilët nuk janë të akredituar, si dhe të marrë masa për të kalibruar dhe mirëmbajtur aparaturat e laboratorit nga një trupë e pajisur me certifikatat përkatëse sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare.
- për trajnimin e stafit dhe përditësimin e njohurive të tij me metodologjinë dhe futjen e standardeve të reja.
- të kryejë krahasime ndërlaboratorike, me laboratorë të tjerë ndërkombëtare, për të rritur performancën dhe besueshmërinë në funksionimin e tij.

Brenda tremujorit të parë 2016

➤ *Lidhur me çështjen se, si ka ndikuar komisioni i shqyrtimit të gjobave në garantimin e cilësisë së karburanteve*

20. Komisioni të shqyrtojë rastet vetëm në plotësim të dokumentacionit të vendosur në kuadrin përkatës rregullator, në një kohë sa më të shpejtë të mundshme, duke rritur ndjeshëm rolin dhe funksionin e vet në garantimin e standardeve të cilësisë së furnizimit të konsumatorëve me karburant.

Vazhdimisht

21. Komisioni të shqyrtojë dhe analizojë me përgjegjësi rastet e shkeljeve nga subjektet, me rigorozitet sipas përcaktimeve në ligjin e posaçëm për t'u ndëshkuar me gjobë, si dhe të penalizojë inspektorët të cilët kryejnë inspektime të papërgjegjshme që arrijnë të shmangen subjektet nga dënimi administrativ.

➤ *Lidhur me çështjen në se, kanë ndikuar aspektet e menaxhimit financiar të Inspektoratit në përmirësimin e cilësisë së tregut të karburanteve:*

22. ISHTI të marrë masat e nevojshme për realizimin në kohë dhe me efektivitet të investimeve për të gjithë fondin e akorduar, duke i dhënë përparësi modernizimit të pajisjeve të laboratorit, si dhe të shikojë mundësinë e pajisjes dhe vënies në punë të autolaboratorit në një kohë sa më të shpejtë.

Vazhdimisht

23. ISHTI të marrë masat e nevojshme për hartimin e një programimi të qartë në fillim të vitit për numrin e subjekteve që ligji i detyron për marrjen periodike të mostrës dhe pajisjen me vërtetim teknik sipas zonave, ka ulur performancën financiare të IQT-së në grumbullimin e të ardhurave dytësore.

Brenda muajit Janar 2016

24. ISHTI të marrë masat e nevojshme për zbatimin e të gjitha rrugëve ligjore për arkëtimin e detyrimeve debitore, me synim shmangien e krijimit në të ardhmen, si dhe kërkimin me prioritet të subjekteve që janë në prag të afatit të shuarjes së këtyre detyrimeve.

Vazhdimisht

25. ISHTI të rishikojë dhe të vlerësojë të gjithë dokumentacionin mbi rezultatet e analizave laboratorike që nga muaji janar 2015, duke evidentuar, regjistruar dhe kërkuar arkëtimin e tarifës për mostrat e analizave të cilat kanë rezultuar jashtë standardeve të cilësisë.

Brenda muajit Janar 2016

26. ISHTI të hartojë dhe të miratojë procedura të sakta dhe të qarta me përgjegjësi për secilin punonjës mbi qarkullimin e mostrave me tregues brenda standardit të cilësisë, depozitimin, ruajtjen dhe administrimin e tyre, me synim fuqizimin e pavarësisë së inspektimeve dhe rritjen e efektivitetit të shpenzimeve buxhetore.

Brenda muajit Janar 2016

➤ *Lidhur me çështjen se, sa efektive është IQT të zbatimin e dënimeve administrative me vendosje gjoha:*


27. ISHTI të përcaktojë qartë në procesverbalin e inspektimit adresën e subjektit dhe vendodhjen e tij, të bashkëpunojë me organet tatimore dhe QKR për këtë qëllim, duke rritur kërkesën e llogarisë, evidentuar dhe ndëshkuar papërgjegjshmërinë e inspektorëve që shfaqen në raste të tilla, me qëllim shmangien plotësisht të humbjeve të tilla të çështjeve gjyqësore.

Vazhdimisht

28. ISHTI të analizojë në mënyrë të veçantë veprimtarinë sektorit juridik dhe DSHB-së, duke evidentuar dhe pasqyruar qartë një bilanc të gjobave të vendosura në numër dhe në vlerë me historikun përkatës deri në arkëtimin e tyre, duke evidentuar mangësitë e shfaqura, me synim rritjen e forcës goditëse ligjore për ndëshkimin real të subjekteve që hedhin në treg karburante jashtë standardeve të cilësisë, në funksion të garancisë së të drejtës së konsumatorëve dhe taksapaguesve shqiptar.

Brenda tremujorit të parë 2016

Drejtori
Rinald Muça



Grupi i auditimit
Gjovalin Preçi
Andi Buzo

Tiranë, Dhjetor 2015